

VENDIM
Nr.776, datë 14.12.2005

PËR VENDOSJEN E ÇMIMEVE TË REDUKTUARA TË BILETAVE TË MUZEVE
PUBLIKE PËR KATEGORI TË ÇAKTUARA SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë reduktim, në masën 50 për qind të çmimit të biletave për muzetë publikë, kategoritë e mëposhtme shoqërore:

a) Pensionistët, që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare, sipas ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) Veteranët e luftës, që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar;

c) Ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, që kanë dëshmi zyrtare, identifikimi, sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar;

ç) Invalidët që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi, sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;

d) Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi, si dhe personat, që i shoqërojnë ata, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

dh) Jetimët që gëzojnë këtë status, sipas ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar;

e) Personat, që përfitojnë nga marrëveshjet dy a shumëpalëshe, të lidhura ndërmjet muzeve publikë shqiptarë dhe muzeve homologë të vendeve të tjera.

Për studentët e arsimit të lartë, që kanë kartën e studentit, sipas ligjit nr.8641, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nxënësit e sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuar sipas ligjit nr.7952, datë 21.11.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, kur janë në grup dhe kur kjo vizitë u shërben për qëllime mësimore, hyrja është e lirë, me tarifë zero.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e këtyre muzeve.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha